

## Vendim nr. 329, datë 16.12.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 16.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (J) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **JETMIR KOXHERI**, përfaqësuar nga avokati Elvin Dalti, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-769, datë 12.05.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 17, 31, 42, 116, 117, 118, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 403, 425, 432, 450 e vijues të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi është proceduar penalisht për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të ngelur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “ë”, 22 dhe 278, paragrafi 1, të Kodit Penal (KP). Nga rrethanat ka rezultuar se në datën 18.06.2019 kërkuesi dhe shtetasi H.Rr. janë konfliktuar fizikisht në ambientet e një lokali, konflikti i cili ka vijuar edhe gjatë kohës që ky i fundit po kthehej në banesën e tij. Disa minuta më vonë kërkuesi ka shkuar pranë banesës ku banonte shtetasi H.Rr. dhe ka debatuar në distancë me të, konflikti i cili është kthyer sërish fizik midis tyre. Më pas, kërkuesi është larguar për t’u rikthyer me një armë automatike dhe ka qëndruar jashtë derës së apartamentit të shtetasit H.Rr. duke i kërkuar të dilte për t’u sqaruar. Nisur nga fakti se ai nuk ka dalë, kërkuesi ka qëlluar në drejtim të derës, ku si pasojë e qitjes është plagosur rëndë fëmija i mitur i shtetasit H.Rr., i moshës 6 vjeç, me katër plumba. Të nesërmen e ngjarjes kërkuesi është vetëdorëzuar dhe është gjetur arma e përdorur në ngjarjen penale.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 169, datë 23.12.2020, me ritin e gjyqimit të zakonshëm, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprat penale për të cilat akuzohej dhe në bashkim të dënimeve e ka dënuar përfundimisht me 30 vjet burgim. Sipas gjykatës, kërkuesi ka konsumuar të gjitha elementet objektive e subjektive të veprave penale. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 520, datë 01.11.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtin arsyetim, për sa i përket fajësisë dhe kualifikimit ligjor të veprave penale, por me ndryshimin e masës së dënimit në 25 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi, ndërsa në datën 12.05.2025 ka paraqitur në Gjykatën e Lartë parashtrime në lidhje me rekursin, duke kërkuar prishjen e dy vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-769, datë 12.05.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

5. Në datën 23.09.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

- 6.1. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi në gjykatën e apelit mbrojtësi i kërkuetit ka paraqitur tre kërkesa për përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes të gjyqtarës E.T., për shkak të një konflikti të mëparshëm midis bashkëshortit të saj dhe mbrojtësit. Këto kërkesa janë rrëzuar nga gjykata, e cila ka aplikuar edhe gjoba ndaj mbrojtësit për shkak të zvarritjes së procesit. Në këtë mënyrë gjykata e apelit ka vepruar në mënyrë ndëshkuese ndaj kërkuetit, duke krijuar dyshime për paanshmërinë objektive dhe subjektive të trupit gjykues. Ndonëse gjyqtari ka pasur detyrimin të heqë dorë nga gjykimi i çështjes nëse nuk ofronte garanci të mjaftueshme për paanshmërinë e tij, ky fakt nuk ka ndodhur në rastin e kërkuetit, por ai është paragjykuar.
- 6.2. *E drejta për t'u mbrojtur*, sepse gjykata e apelit pasi ka rrëzuar kërkesat për përjashtimin e gjyqtarës nga trupi gjykues, ka vijuar gjykimin me një mbrojtëse të caktuar kryesisht. Kjo e fundit nuk e ka përmbushur detyrën në interes të kërkuetit, në kuptim të studimit të dosjes gjyqësore dhe përgatitjes së mbrojtjes në një nivel profesional të përshtatshëm. Në këtë mënyrë mbrojtësja e caktuar kryesisht nuk ka realizuar një mbrojtje efektive. Ndonëse ky pretendim u paraqit në Gjykatën e Lartë, ajo i është shmangur rolit të saj si garante e ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për më tepër, Gjykata e Lartë ka refuzuar të marrë në shqyrtim parashtrimet shtesë të kërkuetit të datës 12.05.2025, duke i konsideruar ato jashtë afatit dhe se ato ishin paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e jo nga kërkueti.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuetit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat

negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për pasojë, ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 12.05.2025, i cili i është komunikuar mbrojtësit në datën 18.07.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 23.09.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

11. Për sa i përket kriterit të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe së drejtës për t’u mbrojtur, të cilat *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*

12. Kërkuesi ka pretenduar se në gjykatën e apelit mbrojtësi i tij ka paraqitur tre kërkesa për përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes të gjyqtares E.T., për shkak të një konflikti të mëparshëm midis bashkëshortit të saj dhe mbrojtësit. Këto kërkesa janë rrëzuar nga gjykata, e cila ka aplikuar edhe gjyba ndaj mbrojtësit, për shkak të zvarritjes së procesit. Në këtë mënyrë, sipas kërkuetit, gjykata e apelit ka vepruar në mënyrë ndëshkuese ndaj tij, duke krijuar dyshime për paanshmërinë objektive dhe subjektive të trupit gjykues. Po sipas kërkuetit, ndonëse gjyqtari ka detyrim të heqë dorë nga shqyrtimi i çështjes nëse nuk ofron garanci të mjaftueshme për paanshmërinë e tij, ky fakt nuk ka ndodhur, por ai është paragjykuar.

13. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme. E drejta për një gjykatë

të paanshme nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po kështu, Gjykata ka pohuar se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëmrisht i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se në gjykatën e apelit kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit të tij, ka paraqitur tre kërkesa për përjashtimin e gjyqtares E.T., me pretendimin se mbrojtësi ndodhej në konflikt me të, pasi ka paraqitur kallëzim penal ndaj bashkëshortit të gjyqtares, duke i kërkuar asaj heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

16. Për kërkesën e parë për përjashtim, Kolegji vëren se me vendimin nr. 451, datë 18.10.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur rrëzimi i kërkesës së kërkuesit për përjashtimin e gjyqtares nga gjykimi i çështjes penale. Për kërkesën e dytë, me vendimin nr. 484, datë 26.10.2021, ajo gjykatë ka vendosur mospranimin dhe gjobitjen e mbrojtësit në shumën 10.000 lekë, ndërsa për kërkesën e tretë, me vendimin nr. 519, datë 01.11.2021, ka vendosur mospranimin dhe gjobitjen e mbrojtësit në shumën 15.000 lekë.

17. Kolegji vëren se pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është ngritur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila ka vlerësuar se nga interpretimi i nenit 17 të KPP-së nuk rezulton të jetë parashikuar si rast papajtueshmërie, ai i konfliktit të bashkëshortit të gjyqtares me mbrojtësin e palës. Shkronja “ç” e pikës 1 të nenit 17

parashikon si rast kur gjyqtari duhet të heqë dorë, kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njëren prej palëve private dhe në këtë dispozitë nuk parashikohet si rast papajtueshmërie, ai i mosmarrëveshjeve të bashkëshortit të gjyqtares me mbrojtësin e palëve. Sipas Gjykatës së Lartë ligjvënësi nuk e ka njësuar mbrojtësin me palën, pasi në rastet kur ka dashur t'i referohet këtij të fundit, e ka individualizuar atë si “mbrojtës” ose “përfaqësues i palës” (shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni).

18. Po kështu, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim edhe shkakun tjetër të parashikuar në këtë nen, shkronjën “ë”, pra kur gjyqtari ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16 (papajtueshmëria për shkak të pjesëmarrjes në procedim ose për arsye lidhjeje familjare, gjinie ose krushqie), si dhe vendimet e gjykatës së apelit që kanë rrëzuar kërkesat për përjashtim. Sipas këtyre vendimeve, zgjedhja me vullnet të lirë e një mbrojtësi, që pretendon të ketë konflikt me gjyqtarin e çështjes, nuk përbën një fakt që justifikon kërkesën për përjashtimin e këtij të fundit, që në çdo rast caktohet me short dhe nuk mund të zgjidhet nga asnjë prej palëve në proces. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se për gjyqtarin e çështjes lind detyrimi subjektiv që të heqë dorë nga gjykimi, në rastet e përcaktuara në nenet 15, 16, 17 dhe 18 të KPP-së. Në të kundërt, nëse asnjë nga rrethanat e përcaktuara në këto dispozita nuk ekziston, gjyqtari duhet të përmbushë detyrën e tij për çështjen e ngarkuar me short. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë i ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet e kërkuarit, me arsyetimin se mbrojtësit kanë për detyrë mbrojtjen e të drejtave të palëve në proces dhe nuk mund të abuzojnë me të drejtat e njohura me ligj, aq më pak të synojnë zgjedhjen e gjyqtarit të çështjes.

19. Në analizë të standardeve kushtetuese të lartpërmendura dhe kontekstit të rrethanave të çështjes, Kolegji konstaton se kërkuari nuk ka paraqitur ndonjë provë ose fakt bindës që të vërë në dyshim paanshmërinë e gjyqtares E.T. si kryesuese e trupit gjykues, si dhe nuk ka arritur të provojë sesi faktet e pretenduara nga ai kanë ndikuar në vendimmarrje. Ekzistenca e konfliktit të mbrojtësit me bashkëshortin e gjyqtares nuk ka arsye të vërë në dyshim paanshmërinë e saj, për më tepër kur një shkak i tillë nuk është i parashikuar nga legjislacioni procedural penal. Kolegji vlerëson se vetëm fakti se gjykata e apelit ka gjobitur dy herë mbrojtësin e kërkuarit, duke i konsideruar kërkesat për përjashtim si abuzive, nuk përbën në vetvete shkak për të dyshuar për anshmërinë e trupit gjykues. Po kështu, sikurse rezulton nga procesverbalet e seancave gjyqësore, kërkuari ka pasur edhe një tjetër avokat të zgjedhur, përveç avokatit N.P. Për këtë shkak në momentin e njohjes me trupin gjykues dhe evidentimit të konfliktit me bashkëshortin e gjyqtares E.T. të avokatit, kërkuari ka pasur mundësi të vazhdojë gjykimin me avokatin tjetër të zgjedhur prej tij, B.R.

20. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme ka marrë përgjigje nga gjykata e apelit. Kolegji vlerëson se arsyetimi i kësaj gjykate ndaj kërkesave të kërkuarit për përjashtimin e gjyqtarës, i cili më pas është kontrolluar nga Gjykata e Lartë, nuk është haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Në këtë kuptim, vlerësohet se paanshmëria e gjyqtarës në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk duket se lë shkas për dyshime për të vënë në diskutim vendimmarrjen e asaj gjykate, për rrjedhojë pretendimi i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

### *C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur*

21. Kërkuari ka pretenduar se gjykata e apelit, pasi ka rrëzuar kërkesat për përjashtimin e gjyqtarës nga trupi gjykues, ka vijuar gjykimin me një mbrojtëse të caktuar kryesisht. Kjo e fundit, sipas kërkuarit, nuk e ka përmbushur detyrën në interes të tij, në kuptim të studimit të dosjes dhe përgatitjes së mbrojtjes në një nivel profesional të përshtatshëm. Në këtë mënyrë mbrojtësja kryesisht nuk ka realizuar një mbrojtje efektive. Kërkuari ka pretenduar gjithashtu se ndonëse ky pretendim u paraqit në Gjykatën e Lartë, ajo i është shmangur rolit të saj të garantës së ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për më tepër, sipas tij, Gjykata e Lartë ka refuzuar të marrë në shqyrtim parashtrimet shtesë të datës 12.05.2025, duke i konsideruar ato jashtë afatit dhe se ishin paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët, e jo nga kërkuari.

22. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka evidentuar se e drejta e mbrojtjes duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve. Veçanërisht në procesin penal, mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 71, datë 30.11.2016; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Referuar standardeve të mësipërme kushtetuese dhe pretendimeve të kërkuesit, Kolegji do të analizojë nëse në rastin konkret gjykatat i kanë garantuar atij të drejtën për t'u mbrojtur, nëse kjo mbrojtje ka qenë reale dhe efektive, si dhe nëse Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim pretendimet shtesë të tij.

24. Nga materialet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se në gjykatën e apelit kërkuesi ka deklaruar se dëshiron të përfaqësohet nga avokati B.R. Në kushtet kur ky i fundit nuk është paraqitur në tre seancat pasardhëse, gjykata e apelit ka vendosur caktimin e një mbrojtëseje kryesisht, duke i lënë kohë asaj për të studiuar aktet e dosjes dhe duke caktuar datën e seancës më 21.09.2021. Në këtë datë janë paraqitur avokati B.R. dhe mbrojtësja e caktuar kryesisht. Po në këtë seancë është relatuar kërkesa e avokatit tjetër të kërkuesit, N.P., për shtyrje, ndërsa avokati B.R. ka deklaruar se nuk dëshiron të vazhdojë mbrojtjen bashkë me avokatin tjetër, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata.

25. Në seancën e datës 07.10.2021 avokati N.P. ka kërkuar shtyrjen e seancës, me qëllim njohjen me aktet e dosjes gjyqësore. Gjykata e apelit e ka vlerësuar si të pajustificuar kërkesën për shtyrje, por për shkak se kërkuesi nuk ka qenë prezent, ka vlerësuar që avokatit t'i jepet kohë për të studiuar dosjen, duke caktuar seancën e radhës në datën 18.10.2021. Edhe në seancën e radhës avokati ka paraqitur kërkesë për shtyrje për shkaqe shëndetësore, e cila është pranuar nga gjykata. Në seancën e datës 25.10.2021 avokati ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrje, me arsyetimin se ndodhej në një emision televiziv, si dhe ka pretenduar se nuk i është vënë në dispozicion dosja gjyqësore. Gjykata e apelit i ka gjetur të pabazuara dhe të pajustificuara kërkesat, pasi marrja pjesë në një emision televiziv nuk përbën shkak për shtyrje, po kështu, sipas saj, avokati ka pasur mundësi për t'u njohur me aktet e dosjes në datën 07.10.2021 dhe nuk e ka bërë një kërkesë të tillë. Në këto kushte, mbrojtja e kërkuesit është realizuar nëpërmjet mbrojtëses së caktuar kryesisht. Gjykata e apelit i ka dhënë fund shqyrtimit gjyqësor dhe është tërhequr për vendim, por nuk e ka shpallur atë pasi nuk ishte shqyrtuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës E.T. Në seancën e datës 01.11.2021, në praninë e avokatit N.P. dhe mbrojtëses kryesisht, pas rrëzimit të dy kërkesave për përjashtim, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për dënimin e kërkuesit, duke ndryshuar vetëm masën e dënimit në 25 vjet burgim.

26. Nga sa më lart, Kolegji vëren se gjykata e apelit e ka realizuar rregullisht thirrjen e mbrojtësit të zgjedhur nga kërkuesi, duke shtyrë disa herë seancat gjyqësore dhe duke i lënë kohën e mjaftueshme për t'u njohur me aktet e dosjes gjyqësore. Në kushtet kur ai nuk është paraqitur, gjykata ka caktuar që mbrojtja të vijojë me mbrojtësen e caktuar kryesisht në respektim të rregullave procedurale penale, duke garantuar kështu për kërkuesin të drejtën për t'u mbrojtur me

avokat. Po kështu, rezulton se kjo mbrojtëse ka qenë e pranishme në disa seanca gjyqësore, si dhe ka pasur një kohë pothuajse dymujore për studimin e dosjes. Kolegji vëren se ky pretendim i kërkuarit është analizuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se caktimi i mbrojtëses kryesisht nga ana e gjykatës së apelit është i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi ajo gjykatë ka vënë në dijeni kërkuarin dhe i ka dhënë mundësi mbrojtëses kryesisht të njëjtit me aktet e dosjet, me qëllim realizimin e një mbrojtjeje efektive, duke arritur në përfundimin se kjo ka qenë një vendimmarrje e pacenueshme nga ana e gjykatës së apelit, e cila në këtë mënyrë ka zbatuar detyrën e saj për sigurimin e mbrojtjes efektive. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit ka përmbushur detyrimin e saj për të garantuar të drejtën e kërkuarit për t'u mbrojtur në këtë aspekt.

27. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit se argumentet e mbrojtëses së caktuar kryesisht nuk kanë qenë në nivel profesional të përshtatshëm, nga përmbajtja e parashtrimeve përfundimtare, Kolegji vëren se ajo ka kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e akteve për rigjykim, pasi vendimi i fajësisë së kërkuarit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe pa analizuar rrethanat përse vepra penale ka mbetur në tentativë dhe se gjykata ka gabuar në cilësimin juridik të veprës penale. Në analizë të këtyre parashtrimeve, Kolegji çmon se nuk arrihet të provohet se mbrojtja ka qenë në nivel të papërshtatshëm apo se ajo ka ndikuar negativisht në zgjidhjen e çështjes së kërkuarit. Vetë ky i fundit nuk ka parashtruar asnjë argument se çfarë shkaqe të reja do të mund të paraqiste në diskutimet përfundimtare në gjykatën e apelit nëse do të përfaqësohej nga avokati i zgjedhur prej tij, për më tepër kur ajo gjykatë ka vendosur uljen e dënimit të tij me 5 vjet në raport me vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

28. Ndërsa lidhur me pretendimin se Gjykata e Lartë ka refuzuar të marrë në shqyrtim parashtrimet shtesë të kërkuarit të datës 12.05.2025, duke i konsideruar ato jashtë afatit dhe se ish-in paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët, Kolegji vëren se ajo gjykatë e ka pasqyruar faktin e paraqitjes së këtyre parashtrimeve (*shih paragrafin 70 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), duke i kthyer përgjigje se ato janë paraqitur ditën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë i ka vlerësuar parashtrimet të paraqitura jashtë afatit të parashkuar në nenin 415, pikat 2 dhe 3, të KPP-së, si një dispozitë e përgjithshme lidhur me ankimet, si dhe të nënshkruara nga mbrojtësi i palegjitimuar, i caktuar me prokurë të familjarëve. Sipas përmbajtjes së këtij neni, ai që ka bërë ankim ka të drejtë që deri pesë ditë para seancës të paraqesë në sekretarinë e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen, parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Në analizë të këtij parashikimi ligjor, Kolegji vlerëson se ky arsyetim i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar, për sa kohë parashtrimet shtesë

janë depozituar ditën e shqyrtimit të rekursit të kërkuarit në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.